

KRITERE PËR GJURMINMIN E BANESËS POPULLORE

Procesi i gjurmimit dhe i përzgjedhjes së ndërtimeve popullore të vëna në mbrojtje nuk mund të bëhet në mënyrë rastësore, sepse mbi të gjitha ajo është një punë me shumë përgjegjësi, si për të ardhmen e kulturës kombëtare, ashtu dhe për mënyrën dhe nevojën për mirëmbajtje. Për këtë arsye, përcaktimi i kriterëve vlerësues do të ishte pikënisja e këtij procesi të gjatë gjurmues, dokumentues, seleksionues dhe propozues për të vënë në mbrojtje shtetërore ekzemplarët më me vlerë të kësaj gjinie ndërtimore.

Kriteri i parë dhe themelori i përzgjedhjes do të buronte nga vetë përcaktimi i nocionit të monumentit si një binom vlerash historike dhe arkitektonike. Kështu, Karta e Venecias që në nenin e parë jep një përkufizim të qartë të nocionit monument: *“Nocioni i monumentit historik përfshin një krijim arkitektonik të veçuar, gjithashtu dhe ansamblët qytetare dhe fshatare që bartin dëshmi të një qytetërimi të veçantë, të një zhvillimi të shënuar ose të një ngjarjeje historike. Ai shtrihet jo vetëm mbi krijimet e mëdha por gjithashtu dhe mbi veprat modeste që kanë fituar me kohë një vlerë kulturore”*.

Ndërtimet popullore të ngritura për plotësimin e kërkesave jetësore të popullsisë dhe në përputhje me kushtet ekononiko-shoqërore të kësaj popullsie, pasqyrojnë në mënyrë besnike mënyrën e jetesës së popullsisë të një krahine apo qendre të caktuar në një periudhë historike të caktuar. Në këtë mënyrë ndërtimet popullore e kanë siguruar vlerën e tyre historike, faktorin e parë përcaktues të nocionit monument.

Lidhur me këtë përkufizim del e nevojshme njohja e kontekstit historik, ekonomik e shoqëror të një krahine të caktuar që kanë përcaktuar ecurinë dhe tiparet e arkitekturë popullore.

Kjo do të jetë dhe detyra e parë e grupit studimor për gjurmimin e ndërtimeve popullore.

Por c’ kuptojmë me ***ndërtime popullore***.

Në radhë të parë vjen në konsideratë kuptimi i vendbanimit.

Fshati ose vendbanimi është një bashkësi territoriale me funksione ekonomik-shoqërore dhe, në mënyrë të veçantë, me kufij të përcaktuar shumë qartë. Kufiri i fshatit përmbledh territorin e banuar dhe atë ekonomik, pronat vetjake dhe ato të përdorimit kolektiv, për kullotë, dru e lëndë etj.

Një njësi më e madhe territoriale është *krahina*, si bashkësi e shumë fshatrave me marrëdhënie të ngushta e të dendura ndërmjet tyre. Krahina karakterizohet nga organizimi i njëjtë shoqëror dhe ekonomik, nga mënyra e njëjtë e jetesës, nga prodhimi i përbashkët kulturor, si rezultat i bashkëjetesës shekullore në një zonë të caktuar gjeografike.

Historiku i vendbanimit, origjina e tij, si ka lëvizur në kohë vendbanimi, okupimi ekonomik i banorëve, bujqësorë apo blegtores, apo zanatçinjtë, lëvizjet e popullsisë etj., janë faktorë që ndikojnë në formulimin urbanistik të vendbanimit.

Kështu ka raste kur vendbanimi shtrihej në lartësi, ndërsa më vonë si ndryshim i kushteve ekonomiko-shoqërore, ai zbriste në zona më të ulëta ose pranë, siç janë psh. fshatrat e krahinës së Dropullit. Përkatësia e ndryshme kohore e vendbanimit fillestar dhe atij të ri sigurisht do të kenë ndryshime edhe në tiparet urbanistike të tyre.

Raste të tjera të njohura janë formimet e vendbanimeve të reja me origjinë të njëjtë. Fshati fillestar duke pasur sipër në mal kullosat dhe poshtë në lumë tokat bujqësore, me kalimin e kohës njësitë e reja, sipër dhe poshtë, u kthyen nga vendbanime provizore në vendbanime të përhershme, duke marrë dhe atributet, X-mal, X-vëri ose X-zall, apo X-i poshtëm e X-i sipërm.

Tiparet thelbësore të vendbanimeve, si lidhja me reliefin, karakteri i përmblendhur apo i shpërndarë, grupime në lagje me origjinë të përbashkët farefisnore, vijnë në konsideratë të parë për studimin e tyre.

Më tej detajohet struktura urbanistike.

- Shpërndarja e rrjetit rrugor
- Tipat e kalldrëimit të rrugëve e rrugicave
- Vendosja e banesave në lidhje me rrugët, dalin me pamjet e tyre kryesore mbi rrugë, apo janë të futura në brendësi mbrapa mureve rrethuese
- Ndikimi i ndërtesave të kultit në formulimin urbanistik të vendbanimit
- Si është raportii zonës së banuar me zonën ekonomike, tokat e punëshme, lëmenjtë, mullinjtë etj. Kështu lëmi mund të ndërtohet në oborrin e banesës, ose mund të okupojnë një zonë të tërë, si në Grapsh. Po kështu në Dardhë mullinjtë janë ngritur në një zonë më vetë, aty ku kalonte përroi i fshatit. Stanet mund të jenë të veçanta për çdo familje por dhe kolektive.
- Cilat janë elementet e “mobilimit urbanistik”, çizmat, portat, sofatet etj.

Mbasi studiojmë këto njësi kalojmë te nocioni i banesës ose shtëpisë.

Shtëpia ose banesa mbeti për një kohë të gjatë njësi bazë ekonomiko-shoqërore, e cila përmbushte kërkesat themelore materiale e shpirtërore të familjes fshatare. Prandaj dhe koncepti “shtëpi”, tradicionalisht përfshin të gjitha ndërtimet me funksion banimi ose jo, kryesore a ndihmëse të ngritura brenda rrethimit të oborrit. Përveç kësaj ekonomia shtëpiake shtrihej dhe në territorin

jashtë rrethimit të oborrit, si në kopshtet, arat etj., mbi të cilat familja kishte të drejtën e plotë të pronës. Ky kuptim i shtëpisë i ngulitur në vetëdijen e popullit, ka qenë i kodifikuar dhe në të drejtën zakonore.

Kështu, Kanuni i Lekë Dukagjinit përcakton : *“Çdo ndërtesë që gjindet n’oborr, është i njitun me shpi, pse gjindet në hije të saj; po u thye, ka giobë e dy për një”*, ndërsa më tej: *“Shkaf â shpi, qi qet tym, do të ket pronet e veta”*, të cilat përcaktohen në këtë mënyrë: *“Plangu i ships ká oborr e kopshte, ká vneshtë e arë, ká livadh e xána, ká udhë e shteg, ká kufij si në mal, si në vrrri, si në fushë”*.

Studimi i organizimit të oborrit dhe ndërtimeve që ai përmban merr një rëndësi, sepse hedh dritë mbi karakterin ekonomik e shoqëror të familjes, të gjendjes ekonomike, karakterit të ekonomisë, marrëdhënieve familjare etj.

Le të marrim disa shembuj. Ambientet ndihmëse për blegtorinë, stallat, për aktivitetin bujqësor, kasollet e strehimit të veglave bujqësore, vendet e përpunimit të prodhimeve bujqësore etj., raportet hapësinore të këtyre ambienteve dëshmojnë për mbizotërimin e një dege ekonomike mbi tjetrën. Elemente të tjera treguese janë lëmenjtë. Ato mund të jenë familjarë dhe ndërtohen në oborrin e banesës, ose kolektive të ndërtuara zakonisht jashtë territorit të banuar. Po kështu ndodh dhe me stanet, të cilat mund të jenë familjare apo kolektive.

Çdo periudhë historike dhe çdo krahinë karakterizohet nga mbizotërimi i një tipologjie të caktuar banese. Tipat e banesës paraqiten me një numër të caktuar variantesh, të kuptuara këto si realizime të së njëjtës ide kompozicionale. Këta të fundit u përmbahen besnikërisht koncepteve themelore që përcaktojnë tipin, por ndryshojnë nga njëri-tjetri për sa i përket numrit të mjediseve dhe në përgjithësi trajtimin arkitektoniko-konstruktiv.

Por variantet e ndryshme të të njëjtit tip pasqyrojnë fazat e zhvillimit të tij, sepse kristalizimi i një prototipi nuk ishte i menjëhershëm. Një numër shembujsh dëshmojnë për rrugën historike që ka ndjekur formimi tipologjik deri sa arriti në format më të përkryera. Këta shembuj përfaqësojnë etapa të ndryshme drejt formimit tipologjik, të cilat duhen dokumentuar për të shërbyer gjykimit për vendosjen në mbrojtje.

Për rezultatin përfundimtar, propozimit për vënie në mbrojtje mirren në konsideratë edhe faktorë të tjerë:

- Një tip i caktuar nuk shfaqet me të njëjtat tipare në qendra të ndryshme. Ato mund të përmbajnë disa karakteristika specifike. Por edhe këta shembuj duhet dokumentuar sepse

dëshmojnë për përhapjen gjeografike të një tipi të caktuar, që i jep zhvillimit tipologjik një karakter ndërkrahinor.

- Gjithashtu dhe një fenomen i arkitekturës popullore i shfaqur në krahina të ndryshme merr dhe formulime të ndryshme. Psh. një formë fortifikimi i banesës që është quajtur “banesa me kullë”. Dokumentimi i këtyre formave dëshmon për karakterin e larmishëm të arkitekturës popullore.
- Një tjetër kriter i rëndësishëm që duhej mbajtur parasysh është dhe kriteri i autenticitetit. Ndërmjet shembujve të shumtë banesash me vlerë, do të përzgjidhen dhe ata shembuj që kishin ruajtur sa më shumë tiparet autentike, të cilat do të na dëshmonin më me vërtetësi karakterin e një tipologjie të caktuar.
- Gjendja teknike e monumentit do të kishte dhe ajo rolin e saj në përzgjedhjen e shembujve për t’u vënë në mbrojtje. Ndërmjet shembujve të ngjashëm do të parapëlqen ato në gjendje më të shëndoshë, sepse restaurimi, përveç përparësive, përmbante dhe rreziqe për cenimin e vlerave autentike.

Prirjet tipizuese, që për vetë karakterin masiv të ndërtimit dhe sensin e qartë utilitar, janë në natyrën e kësaj krijimtarië, por ato nuk janë kuptuar si faktorë frenues. Përkundrazi, në përshtatje me kushtet e reja ekonomiko-shoqërore shkohet drejt kërkimit të formave të reja banimi, ose në tipa të reja banese. Kemi të bëjmë këtu me një proces të natyrshëm zhvillimi dialektik, i cili i përfshin këto hope cilësore, si pasqyrim i ndryshimeve edhe në mënyrën e jetesës.

Përveç vlerave të krijimtarisë ndërtimore popullore si dëshmi dokumentare në planin historik, ajo ruan vlera të padyshimta si krijimtari arkitektonike, pasi na dëshmon se sa dhe si janë zgjidhur drejt dhe në mënyrë racionale kërkesat e kohës.

Mbarë arkitektura popullore shquhet për një sens të zhvilluar funksional. Kompozimet e tipave dhe varianteve të ndryshme duket se kanë arritur t’i përgjigjen mirë kërkesave jetësore të familjes. Kështu, lidhja e kompozimit me funksionin është një tipar me rëndësi i kësaj krijimtarië. Sensi funksional shprehet *së pari*, në kompozimin sa më të arrirë të mjediseve; *së dyti*, në raportin kompozicional ndërmjet ndërtimeve kryesore dhe atyre ndihmëse, të cilat, sipas rastit, përfshihen në trupin e banesës ose ngrihen në oborrin e saj; *së treti*, në formulimin e njësive të ndryshme kompozicionale, në të cilat elementet përbërëse janë vendosur në përshtatje me funksionin e çdo mjedisi.

Një tipar tjetër i rëndësishëm i arkitekturës popullore është dhe shfrytëzimi racional i materialeve natyrorë, të cilët, në përputhje me cilësitë e tyre fiziko-teknike, janë përdorur në forma të gjetura konstruktive, për të realizuar idenë kompozicionale. Zgjedhja me kujdes e materialeve natyrorë, mënyra e nxjerrjes apo e prerjes, përpunimi i tyre apo vendosja në vepër, tregojnë për një përvojë të gjatë e të frytshme.

Në mbarë krijimtarinë ndërtimore popullore vërehet një përkujdesje e vazhdueshme edhe në planin estetik. Përpjesëtimet e gjetura, harmonia, lidhja me shije e materialeve me natyra të ndryshme, e deri përpunimi i elementeve më të thjeshtë, dëshmojnë për rëndësinë që i kushtonin mjeshtrit popullorë trajtimit të veprës arkitektonike. Kështu, elementet konstruktivisht të nevojshëm, si *strehë, korniza, konsola, qoshe, parapete mbrojtëse* etj, i nënshtrohen përpunimit duke marrë një veshje dekorative, e cila nuk e prek funksionin kryesor, por përkundrazi e thekson atë dhe nga ana tjetër, rrit plastikën dekorative të gjithë ndërtesës.

Ndonëse elementet dekorative të interierëve përmbajnë ngarkesën më të madhe estetike, por nuk mungojnë rastet kur dekori shfaqet edhe në pamjet e jashtme, kryesisht në formën e dekorit të gdhendur në gur. Përveç vlerës estetike këto motive përmbajnë dhe një ngarkesë të rëndësishme simbolike lidhur dhe me pjesët e ndërtesës ku ato aplikohen. Kështu dekoracionin më të përhapur e gjejmë në portat si kontaktet e para me vizitorët, për të treguar shfaqjen e mikpritjes. Tjetër pjesë e aplikimit janë dhe qoshet e banesës, si simbol i qëndrueshmërisë së ndërtimit.

Teknologjia popullore është një tjetër degë e rëndësishme e krijimtarisë së popullit. Ndonëse marrëdhëniet ekonomike me qytetin nuk u ndërprejnë asnjëherë, u ngritën instalime prodhimi që i shërbenin plotësimit të nevojave të fshatit, por shpesh destinoheshin dhe për treg. Shumë nga këto instalime tërheqin edhe sot vëmendjen e opinionit shkencor e shoqëror për aftësitë teknike të mjeshtrëve që i ngritën dhe i përdorën. Si shembull mund të përmendim mjeshtrit e punimeve hidrike të mjeshtrëve lunxhiotë të kërkuar në të gjitha viset ballkanike e qendrore të perandorisë osmane, apo të kalldrëmxhinjve oparakë që, sipas dëshmive të tyre, kanë kalldrëmuar rrugët e Stambollit, apo druvarët që ngritën sharra uji deri në Anadoll. Aftësi për shfrytëzimin e energjisë ë ujit i gjejmë që nga mullinjtë e deri te sharrat e ujit. Po kështu punishte artizanale i gjejmë për prodhimin e vajit e prodhimit të qymyrit, apo materialeve të ndërtimit, si për prodhimin e gëlqeres, qerpiçëve e tjegullave.

Përfundimisht mund të themi se përfaqësueset më të arritura të degëve të krijimtarisë të përmendura më sipër duhen seleksionuar dhe vënë në mbrojtje për të shërbyer si sot, ashtu dhe për brezat e ardhëm si dëshmi e jetës së popullit dhe krijimtarisë së tij.